



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 152, Datë 17/07/2018

Mbështetur në informacionin e përcjellë, nëpërmjet kërkesës së datës 27.02.2018, nga ana e disa familjeve të komunitetit egjiptian dhe rom të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, ku parashtroheshin problematika, në lidhje me furnizimin e tyre me energji elektrike, për shkak se janë debitorë me OSHEE sh.a., apo nuk kanë lidhur kontratë shërbimi me këtë shoqëri, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në referencë të gjermës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, filloi procedurat administrative për shqyrtimin e çështjes ex-officio.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin e përcjellë, nëpërmjet kërkesës së datës 27.02.2018, nga ana e disa përfaqësuesve të komunitetit egjiptian dhe rom të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, Komisioneri u njoh me situatën e rreth 74 familjeve, që i përkasin komunitetit egjiptian dhe rom, në këto fshatra, të cilët paraqesin problematika në lidhje me furnizimin me energji elektrike, për shkak se janë debitorë me OSHEE sh.a., apo nuk kanë lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike me këtë shoqëri.

Kërkesa e sipërpërmendur i drejtohej Administratorit të OSHEE sh.a. dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Fier të OSHEE sh.a. dhe për dijeni i përcillet Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryetarit të Bashkisë Fier, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Familjet rome dhe egjiptiane kërkonin si më poshtë vijon:

1. Lidhjen e kontratave të furnizimit me energji elektrike, pajisjen me matës dhe mundësimin e pagesës me kosto të përballeshme të energjisë elektrike;
2. Ristrukturimin e detyrimeve të prapambetura me këste të përballeshme në masën 1000 lekë në muaj;
3. Rilidhjen e emergjisë elektrike, me qëllim mundësimin e nevojave bazë të familjeve të tyre për ndriçim dhe ngrohje.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Në referencë të gërmës c), pika 1, neni 32, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet Urdhërit nr. 54, datë 15.03.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi menjëherë procedurat administrative për shqyrtimin e çështjes ex-officio.
 2. Nëpërmjet shkresës nr. 371/1, datë 15.03.2018, Komisioneri iu drejtua Administratorit të Shoqërisë OSHEE sh.a. dhe Drejtorit pranë Drejtorisë Rajonale Fier të OSHEE sh.a., ku kërkoji informacion mbi çështjen e parashtruar në kërkesën e datës 27.02.2018, e familjeve rome dhe egjiptiane të fshatrave Drizë, Levan e Baltëz, të qytetit të Fierit.
- Për sa më sipër, OSHEE Fier dërgoi shkresën nr. 1060/2, datë 24.03.2018, ku e informon Komisionerin, se pas verifikimeve të kryera në sistemin e faturimit mbi 74 familjet nënshkruese të kërkesës së datës 27.02.2018, rezultoi se 44 prej tyre janë konsumatorë të energjisë elektrike, të cilët janë të lidhur me kontratë të furnizimit me energji elektrike dhe sistem matjeje.

OSHEE sh.a., Fier thekson faktin se banorët e këtyre fshatrave, që duan të lidhin kontratë furnizimi me energji elektrike, duhet të drejtohen në zyrat e kujdesit ndaj klientit për të marrë asistencën e duhur mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin shoqëruar për lidhjen e re.

Në vijim të zbatimit të procedurave për trajtimin e marrëdhënieve kontraktore, në bazë të nenit 11.1 të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jo familjarë, në

mungesë të pagesës nga klienti i faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të pagesës sipas neneve 9.1 dhe 10, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e energjisë elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar të bëjë rilidhjen e furnizimit me energji elektrike brenda 48 orëve nga kryerja e pagesës nga klienti.

Në zbatim të detyrimeve kontraktore, në data 19.01.2018 dhe 22.02.2018 është kryer ndërprerja e furnizimit të energjisë elektrike të 12 abonentëve, të cilët rezultojnë debitorë nga 34 deri në 131 fatura të papaguara. Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, OSHEE sh.a. Fier ka dërguar pranë Komisionerit, listën e abonentëve me numrin e faturave të papaguara, debinë totale dhe datën e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike.

Për ristrukturimin e detyrimeve të prapambetura, Kompania OSHEE sh.a. ofron për abonentët debitorë, në kategorinë familjarë, produktet e ripagesës, si më poshtë:

- ⇒ Konsumatorët familjarë që shprehin vullnetin të kryejë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore me vlerë 2.800 lekë në muaj;
- ⇒ Konsumatorët familjarë të kategorisë ndihmë ekonomike, pensionistë kryfamiljarë, që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore, me vlerë 1.200 lekë në muaj;
- ⇒ Konsumatorët familjarë që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e menjëherëshme të detyrimit, duke përfutur reduktim kamatëvonesë në masën 70%.

Skemat lehtësuese të pagesës me këste i referohen Vendimit të Këshillit Mbikqyrës lidhur me miratimin e skemës dhe afatit të marrëveshjeve për likuidimin me këste të detyrimeve të klientëve debitorë për kategorinë familjarë/jofamiljarë dhe buxhetorë dhe jobuxhetorë.

Në shkresën e sipërpërmendur, theksohet fakti se në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, rilidhja e furnizimit me energjisë elektrike do të kryhet nëse abonentit do të kryejë pagesën ose do të hyjë në produktet e ripagesës, pra të lidhin aktmarrëveshje. Gjatë aplikimit për lidhjen e AKM, klienti do të asistohet nga specialistët e kujdesit ndaj klientit.

- Në përgjigje të shkresës nr. 371/1, datë 15.03.2018, së Komisionerit, Administratori i OSHEE sh.a., dërgoi shkresën nr. 4952/1, datë 27.04.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin, në lidhje me problematikën e parashtruar.

Sipas shkresës së sipërpërmendur, abonentët që kërkojnë lidhjen e kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe pajisje me matës duhet të drejtohen pranë zyrave të kujdesit ndaj klientit, për t'u njohur me procedurën e aplikimit dhe dokumnetacionin shoqëruar që duhet të paraqesin.

Në lidhje me ristrukturimin e detyrimeve të prapambetura, OSHEE sh.a. ofron produktet e ripagesës nëpërmjet skemave lehtësuese referuar Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, me këste mujore të miratuara 2800 lekë dhe 1200 leke. Rilidhja e energjisë elektrike do të realizohet nga OSHEE sh.a., pasi abonenti të nënshkruajë Aktmarrëveshjen, sipas kategorisë ku bën pjesë dhe të kryejë pagesën.

3. Mbështetur në përgjigjet zyrtare të dërguara nga OSHEE sh.a. Fier dhe OSHEE sh.a., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 471/3, datë 05.04.2018, Z. P.A., banues në fshatin rom Drizë, i cili është përfaqësues i familjeve nënshkruese të kërkesës së datës 27.02.2018. Komisioneri e informoi Z. P.A. me përgjigjen zyrtare të OSHEE sh.a. Fier dhe iu kërkua të identifikohen të gjithë familjet nënshkruese, që i përkasin komunitetit egjiptian dhe rom të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë “ndihmë ekonomike” dhe “pensionistë kryefamiljarë”. Në vijim iu kërkua që lista dhe aktet që vërtetonin përkatësinë e tyre, në këto kategori, të dërgohej pranë OSHEE Fier dhe pranë Komisionerit.

- Z. P.A. nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr. 471/3, datë 05.04.2018, së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

4. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, nëpërmjet Urdhërit nr. 92, datë 16.05.2018, të Komisionerit u vendos të kryhej një takim me Z. P.A., në cilësinë e përfaqësuesit të 74 familjeve rome e egjiptiane të fshatrave Drizë, Baltëz e Levan, të qytetit të Fierit, për të kryer konstatimet përkatëse, lidhur me situatën aktuale të këtyre familjeve. Referuar procesverbalit të inspektimit rezultoi se nga 74 familje nënshkruese, 30 prej tyre janë banuese në fshatin Drizë, 4 familje janë banuese në fshatin Baltëz dhe 44 familje janë banuese në fshatin Levan të Fierit.

Nga 30 familje që janë banuese në fshatin Drizë, 28 prej tyre janë të lidhur me kontratë furnizimi të energjisë elektrike me OSHEE sh.a. dhe 2 prej tyre janë pa kontratë. Të 30 familjet e mësipërme, pavarësisht statusit të tyre, aktualisht kanë furnizim me energji elektrike. Në fshatin Baltëz, të Fierit, të katër familjet kanë kontrata të rregullta të furnizimit me energji elektrike, por janë debitore ndaj OSHEE sh.a. Dy prej këtyre familjeve iu është ndërprerë furnizimi me energji elektrike, pasi nuk kanë paguar faturën e muajit mars 2018. Në fshatin Levan të Fierit, rreth 20 familje nuk kanë lidhur kontratë furnizimi të energjisë elektrike me OSHEE Fier, 10 familjeve rome iu është rilidhur energjia elektrike, pasi kanë kryer pagesat përkatëse, ndërsa pjesa tjetër e familjeve rome është pa energji elektrike, pasi është debitore ndaj OSHEE sh.a. Nga të dhënat e marra nga Z. P.A. rezulton se në total rreth 33 familje në fshatin Drizë trajtohen me ndihmë ekonomike dhe vetëm disa prej tyre janë nënshkruese të kërkesës së datës 27.02.2018. Gjatë

takimit u mor informacion mbi faktin se asnjë nga familjet debitore me OSHEE sh.a. nuk ka lidhur Akt-marrëveshje me këtë shoqëri, pasi nuk përballojnë dot vlerat e kësteve mujore prej 2800 lekësh të përcaktuara me Vendim të Këshillit Mbikqyrës.

Në takim u evidentua fakti se familjet rome, që nuk kanë lidhur ende kontratë të furnizimit me energji elektrike me OSHEE sh.a., nuk përballonin dot tarifën për lidhjen e kontratës, e cila kushtonte mbi 20.000 lekë.

Për sa më sipër, Z. P.A. i informoi inspektorët e Komisionerit se ishin realizuar disa takime ndërmjet familjeve rome të fshatrave të sipërpërmendur, me përfaqësues të OSHEE sh.a. Fier e Tiranë, ku familjet rome janë informuar hollësisht mbi çështjet e lidhjes së kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe mbi tarifën që ka vendosur Këshilli Mbikqyrës i OSHEE sh.a., për pagimin e debisë që këto familje kanë ndaj kësaj shoqërie.

Ndër të tjera, Z. P.A. i bëri me dije inspektorët, se këto familje nuk kanë mundësi financiare për të marrë vërtetim, që përfitojnë ndihmë ekonomike, apo qoftë edhe çertifikata familjare, për ata që janë kryefamiljarë pensionistë.

5. Njëkohësisht, Komisioneri iu drejtuar OSHEE sh.a. Fier, nëpërmjet shkresës nr. 679/2, datë 17.05.2018, ku i ka kërkuar informacion lidhur me disa çështje, të cilat parashtrihen si më poshtë:

- ⇒ Informacion mbi faktin, nëse OSHEE sh.a., Fier, ka kontaktuar me familjet rome dhe egjiptiane, që kanë nënshkruar kërkesën e datës 27.02.2018, për t'i udhëzuar ato në lidhje me procedurat që duhet të ndjekin për të lidhur kontrata të furnizimit me energji elektrike apo për t'i informuar mbi skemat lehtësuese dhe kategoritë që përfitojnë prej tyre, për shlyrjen e debisë ndaj OSHEE sh.a.
- ⇒ Identifikimi i familjeve rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit¹, që janë paraqitur pranë zyrave të OSHEE Fier dhe kanë lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHEE sh.a.
- ⇒ Identifikimi i familjeve, që ende nuk kanë lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHEE sh.a.

¹ Bëhet fjale për familjet që janë nënshkruese të kërkesës së datës 27.02.2018.

- ⇒ Nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë qenë të lidhur kontraktualisht me OSHEE sh.a., por kanë patur problematika, pasi janë debitorë, të evidentohen se cilët prej tyre kanë lidhur Aktmarrëveshje për pagimin e debisë, që kanë ndaj OSHEE sh.a. dhe sa prej tyre ende nuk kanë lidhur ende Aktmarrëveshje.
 - ⇒ Numri i familjeve në fjalë, që kanë përfituar nga skemat lehtësuese të parashikuara në Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, lidhur me “Miratimin e skemës dhe afatit të marrëveshjeve për likuidimin me këste të detyrimeve të klientëve debitorë për kategorinë familjar/jofamiljar dhe buxhetorë jo buxhetorë”.
 - ⇒ Identifikimi i familjeve, të cilave iu është rilidhur energjia elektrike, pasi abonentët kanë kryer pagesën ose kanë në hyrë në produktet e ripagesës.
- Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, OSHEE sh.a. Fier, dërgoi shkresën nr. 1060/4, datë 23.05.2018, ku e informon Komisionerin, si më poshtë:
- ⇒ *Lidhur me çështjen e parë*, OSHEE sh.a. Fier informon se strukturat e Njësisë Fier kanë kontaktuar me familjet rome dhe egjiptiane nëpërmjet përfaqësuesit të yre, Z. Panajot Alushaj, ku janë informuar për procedurat që duhet të ndjekin për të lidhur kontrata të furnizimit me energji elektrike, për skemat lehtësuese të pagesës me këste të detyrimeve të prapambetura, si dhe kategoritë që përfitojnë prej tyre.
 - ⇒ *Lidhur me çështjen e dytë*, Komisioneri bëhet me dije, lidhur me faktin se janë paraqitur për të lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike, Z. L.M., i cili është lidhur me energji elektrike dhe Z. V. N., dosja e të cilit nuk është procesuar për shkak të detyrimeve debitorë të kontratës FI1B010037036658 (familjarë të tij).
 - ⇒ *Lidhur me çështjen e tretë*, Nga verifikimet e kryera në terren rezulton se nuk ka konsumatorë të lidhur me rrjetin e furnizimit me energji elektrike pa kontratë.
 - ⇒ *Lidhur me çështjen e katërt*, nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., por janë debitorë kanë lidhur Aktmarrëveshje për pagesën me këste të debisë 2 (dy) konsumatorë, kanë paguar totalin e debisë 2 (dy) konsumatorë, kanë paguar faturat e muajve janar-Prill 2018, 14 (katërbëdhjetë) konsumatorë, kanë paguar faturat e vitit 2017 dhe 2018, 2 (dy) konsumatorë, kanë paguar faturat e muajit Janar-Shkurt 2018 6 (gjashtë) konsumatorë dhe nuk janë paraqitur për të kryer pagesë 18 (tetëmbëdhjetë) konsumatorë.
 - ⇒ *Lidhur me çështjen e pestë*, nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., kanë përfituar nga skemat lehtësuese 2 (dy) familje.

- ⇒ *Lidhur me çështjen e gjashtë*, nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., janë furnizuar me energji elektrike 41 abonentë, 2 (dy) konsumatorë familjarë janë me status përmbarim dhe një abonent vijon i ndërprerë.

Ndër të tjera, OSHEE sh.a. Fier thekson faktin, se është në pritje të miratimit të skemave lehtësuese për pagesën me këste të detyrimeve debitore.

6. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 745/1, datë 29.05.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Kryetarit të Bashkisë Fier. Për dijeni shkresa e sipërcituar iu përçoll edhe Drejtorit të OSHEE sh.a. Fier. Bashkëlidhur kësaj shkrese u dërgua lista e familjeve nënshkruese, të cilat aktualisht kanë lidhur kontratë shërbimi me OSHEE sh.a, por janë debitore ndaj saj dhe nuk kanë lidhur Aktmarrëveshje, për shlyerjen e detyrimit të prapambetur. Mbështetur në listën e sipërpërmendur, Bashkisë Fier iu kërkua të identifikohen ato familje, të cilat janë përfituese të ndihmës ekonomike dhe ata persona që janë kryefamiljarë pensionistë, të cilët mund të përfitojnë nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a., të miratuara me Vendimin nr. 64, datë 27.12.2017, e Këshillit Mbikqyrës.

- Në përgjigje të shkresës nr. 745/1, datë 29.05.2018, së Komisionerit, Bashkia Fier dërgoi shkresën nr. 5291/1, datë 07.06.2018, nëpërmjet së cilës informon se pas verifikimit në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike për muajin maj 2018 rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike 5 (pesë) familje, kryefamiljarët, e të cilave paraqiten, si më poshtë vijojnë:

- ⇒ Z. G. S.
- ⇒ Z. B. A.
- ⇒ Z. A. A.
- ⇒ Z. L. P.
- ⇒ Z. N. Z.

Bashkia Fier nuk ka identifikuar kryefamiljarëve pensionistë, pasi informacioni disponohet nga I.S.SH. Fier. Ndër të tjera, në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se vërtetimet për përfitim ndihmë ekonomike lëshohen falas nga ky institucion.

7. Në vijim, Komisioneri iu drejtua me shkresën nr. 880, datë 19.06.2018, përfaqësuesit të 74 familjeve rome dhe egjiptiane të fshatrave Drizë, Baltëz dhe Levan, të qytetit të Fierit, ku në referencë të shkresës nr. 5291/1, datë 07.06.2018, së Bashkisë Fier e bënte me dije mbi 5 (pesë) familjet që përfitonin ndihmë ekonomike dhe i kërkohet që të kontaktonte me to, në mënyrë që këto të fundit të aplikonin për të përfituar nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a.

Ndër të tjera, Komisioneri i kërkoi Z. P.A., në cilësinë e përfaqësuesit të 74 familjeve rome dhe egjiptiane, të dërgonte në adresë të tij, kopje të kartave të identitetit të kryefamiljarëve ankues.

- Z. P.A. nuk dërgoi përgjigje në adresë të Komisionerit.

8. Për të qartësuar sa më shumë situatën e 74 familjeve rome dhe egjiptiane, e sidomos të 30 familjeve, që aktualisht nuk kanë kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHEE sh.a. Fier, Komisioneri dërgoi 2 (dy) shkresa, si më poshtë vijojnë:

8/1. Shkresën nr. 880/1, datë 25.06.2018, drejtuar Bashkisë Fier, ku iu dërgua bashkëlidhur lista e 30 familjeve rome dhe egjiptiane, që aktualisht nuk kanë lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike me OSHEE sh.a., Fier dhe iu kërkua të identifikoheshin ato familje që ishin përfituese të ndihmës ekonomike.

- Në përgjigje të shkresës nr. 880/1, datë 25.06.2018, të Komisionerit, Bashkia Fier dërgoi shkresën nr. 6122/1, datë 28.06.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se ndër 30 familjet e listuara, vetëm 2 (dy) prej tyre përfitonin ndihmë ekonomike, përkatësisht familjet e Z. A. A. dhe Z. A. A.

8/2. Shkresën nr. 916, datë 26.06.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, ku iu dërgua bashkëlidhur lista e familjeve ankuese dhe iu kërkua të identifikoheshin (a) familjet, që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; (b) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat.

- Në përgjigje të shkresës nr. 916, datë 26.06.2018, të Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier dërgoi shkresën nr. 4410/1, datë 03.07.2018, ku e informon Komisionerin, se për të verifikuar të dhënat përkatëse është e nevojshme të disponohen kopje të kartave të identitetit të kryefamiljarëve të familjeve ankuese.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të çështjes ex-officio rezulton se problematikat e ndeshura me 74 familjet rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, kanë të bëjnë me me dy çështje kryesore. E para konsiston në faktin se një pjesë e madhe e këtyre familjeve, përkatësisht 44 të tilla, janë të lidhura me kontrata të rregullta të furnizimit të energjisë elektrike me OSHEE sh.a., Fier, por janë debitore ndaj kësaj shoqërie. Debia e tyre varion nga 34 deri në 131 fatura të papaguara. Në këto kushte, OSHEE sh.a. Fier ka ndërprerë përkohësisht furnizimin me energji elektrike për disa familje. Furnizimi me energji është rikthyer për një pjesë të tyre pas kryerjes së pagesës së muajit të fundit apo pas lidhjes së Aktmarrëveshjes për shlyerjen e debisë. Çështja e dytë konsiston në faktin se pjesa tjetër e familjeve rome dhe egjiptiane nuk ka lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike dhe si rrjedhim nuk furnizohet nga OSHEE sh.a., Fier.

- ⇒ Për sa i përket çështjes së parë, theksojmë faktin se duke iu referuar nenit 11.1 të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jo familjarë, rezulton se në mungesë të pagesës nga klienti i faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të pagesës sipas neneve 9.1 dhe 10, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e energjisë elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar të bëjë rilidhjen e furnizimit me energji elektrike brenda 48 orëve nga kryerja e pagesës nga klienti.

Kontrata e furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jo familjarë është kontratë tip, e cila përdoret për të gjithë klientët familjarë dhe jo familjarë, pavarësisht racës apo gjendjes ekonomike të tyre dhe ndërprerja e furnizimit me energji elektrike është një veprim që ndërmerret ndaj kujtdo që nuk zbaton detyrimet kontraktore.

Njëkohësisht, neni 16, i Vendimit nr. 203, datë 18.12.2017, të ERE, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë” parashikon: *“Në mungesë të pagesës nga klienti të faturës brenda afatit të përcaktuar në kontratë, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara, në adresën e përcaktuar në kontratë, si dhe sipas përcaktimeve nenit 14, pika 4.”* Sikurse vihet re nga sa më sipër mospagimi i faturës së energjisë elektrike penalizohet me ndërprerje të furnizimit për të gjithë familjet.

Referuar korespondencës zyrtare me OSHEE sh.a. Fier rezulton se aktualisht nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., janë furnizuar me energji elektrike 41 abonentë, 2 (dy) konsumatorë familjarë janë me status përmbarim dhe një abonent vijon i ndërprerë.

Problematika kryesore në këtë grup familjesh rome dhe egjiptiane është shlyerja e debisë që kanë ndaj OSHEE sh.a., Fier. 44 familje të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit janë debitorë ndaj OSHEE sh.a. Për të shlyer debinë e tyre, këto familje duhet të lidhin Aktmarrëveshje me këtë shoqëri.

Referuar Vendimit lidhur me “Miratimin e skemës dhe afatit të marrëveshjeve për likuidimin me këste të detyrimeve të klientëve debitorë për kategorinë familjar/jofamiljar dhe buxhetorë jo buxhetorë” për ristrukturimin e detyrimeve të prapambetura, Kompania OSHEE sh.a. ofron për abonentët debitorë, në kategorinë “Familjarë”, produktet e ripagesës si më poshtë:

- Konsumatorët familjarë, që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore me vlerë 2.800 lekë në muaj;
- Konsumatorët familjarë, të kategorisë “ndihmë ekonomike”, “pensionistë kryefamiljarë, që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore me vlerë 1.200 lekë në muaj;
- Konsumatorët familjarë që shprehin vullnetin të kryejnë pagesën e menjëherëshme të detyrimit, duke përfutur reduktim kamatëvonese në masën 70%.

Në informacionin zyrtar të dërguar nga OSHEE sh.a. Fier, nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., por janë debitorë, rezulton se:

- 2 (dy) konsumatorë kanë lidhur Aktmarrëveshje për pagesën me këste të debisë;
- 2 (dy) konsumatorë kanë paguar totalin e debisë;
- 14 (katërbëdhjetë) konsumatorë kanë paguar faturat e muajve janar-Prill 2018;
- 2 (dy) konsumatorë kanë paguar faturat e vitit 2017 dhe 2018;
- 6 (gjashtë) konsumatorë kanë paguar faturat e muajit Janar-Shkurt 2018;
- 18 (tetëmbëdhjetë) konsumatorë dhe nuk janë paraqitur për të kryer pagesë.

Kategoritë që përfitojnë nga skemat lehtësuese të ofruara nga OSHEE sh.a. janë familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pensionistët kryefamiljarë, ndërkohë që pjesa tjetër e familjeve duhet të kryejnë pagesën e detyrimit me këste fikse mujore me vlerë 2.800 lekë në

muaj. Parashikimet e Vendimit të sipërpërmendur janë të zbatueshme njëloj për të gjithë individët.

Gjatë shqyrtimit administrativ rezultoi se nga 44 konsumatorë të energjisë elektrike, të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të cilët kanë kontratë me OSHEE sh.a., kanë përfituar nga skemat lehtësuese 2 (dy) familje. Referuar informacionit të përcjellë nga Bashkia Fier rezultoi se nga 44 familjet e sipërpërmendura vetëm 5 prej tyre përfitonin ndihmë ekonomike. Në kushtet kur dy prej tyre kanë përfituar nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a. rezultoi se 3 familje të tjera duhet të aplikojnë pranë zyrave përkatëse të OSHEE sh.a. Fier për të përfituar nga këto skema.

Për sa më sipër, vlen të theksohet fakti, se strukturat përkatëse të OSHEE sh.a., Fier kanë luajtur një rol aktiv dhe i kanë informuar familjet nënshkruese rome dhe egjiptiane, mbi skemat lehtësuese, kategoritë që përfitojnë si dhe mbi procedurat që duhen ndjekur, në mënyrë që të rifurnizohen me energji elektrike. Njëkohësisht, vlen për t'u përmendur fakti se për zgjidhjen e kësaj çështjeje janë realizuar edhe disa takime të familjeve në fjalë me përfaqësues të OSHEE sh.a. Fier dhe OSHEE sh.a. në Tiranë.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”², Komisioneri gjykon se 44 familjet rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, të cilat aktualisht kanë kontratë me OSHEE sh.a. Fier, nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e OSHEE sh.a. Fier. Kjo shoqëri ka zbatuar kontratat e furnizimit me energji elektrike të lidhura me familjet, si dhe dispozitat përkatëse në vendimet e ERE dhe Këshillit Mbikqyrës të OSHEE sh.a.

- ⇒ Lidhur me çështjen e dytë, që ka lidhje me 30 familjet rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, të cilat nuk kanë lidhur kontratë me OSHEE sh.a. Fier, Komisioneri konstatoi gjatë shqyrtimit administrativ, se arsyeja kryesore e moslidhjes së kontratave të shërbimit, ishte se këto familje nuk e përballonin dot financiarisht koston e lidhjes së kontratës, si dhe procesin e hartimit të akteve përkatëse, që ishin të nevojshme për lidhjen e kontratave.

Referuar informacionit të dërguar nga OSHEE sh.a., Fier, rezultoi se janë paraqitur për të lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike, Z. L.M., i cili është lidhur me energji elektrike dhe Z.

² Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “ Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

V. N., dosja e të cilit nuk është procesuar për shkak të detyrimeve debitore të kontratës FI1B010037036658 (familjarë të tij). Pjesa tjetër e familjeve rome dhe egjiptiane nuk janë paraqitur për të lidhur kontratat.

Lidhja e kontratave të furnizimit me energji elektrike kryhet mbi bazën e një kërkesë drejtuar strukturave përkatëse të OSHEE sh.a., bashkëlidhur së cilës duhen paraqitur dokumentacioni përkatës, i parashikuar në Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, miratuar me Vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, ndryshuar me Vendimin nr. 177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE.

Në Pjesën II, të Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, parashikohet dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhjeje të re. Pika 2.1, e Pjesës II, të Rregullores së sipërpërmendur parashikon dokumentacionin për lidhjet e reja në TU, për fuqinë e instaluar 0-20 kË, si më poshtë:

“Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Kërkesë për furnizim me energji elektrike;*
- 2. Vërtetim identiteti (fotokopje karte identiteti ose pasaporte)*
- 3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundëshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në process legalizimi)*
- 4. Fotokopje të certifikatës së regjistrimit (për subjektet jo familjarë)*
- 5. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallësn 1:1000 (dy kopje), (të specifikuar koordinatat e konturit të sipërfaqes së objektit).”*

Në pikën 2.2 “Fuqia e instaluar 20-50 kW” dhe pikën 2.3 “Fuqia e instaluar 50-100 kW”, të kësaj rregulloreje, veç akteve të sipërpërmendura, parashikohen edhe akte të tjera, të tilla si Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente, planvendosja e të gjitha pajisjeve në object, Licenca e inxhinierit, i cili ka bërë pojektin elektrik të objektit, Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinieri elektrik i pajisur me licencë, Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë etj.

Pjesa IV e Rregullores së sipërcituar parashikon tarifatat për lidhjet e reja.

Fillimisht, pika 4.1, gërma a) “Parimet e tarifave” parashikon parimet mbi të cilat mbështet përcaktimi i tarifave nga ana e OSHEE sh.a., të cilat parashtrohen si më poshtë:

“Tarifat për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike janë përcaktuar në përputhje me objektivat e mëposhtëme:

1. Mosdiskriminimi;

2. *Transparencë që lidhet me përdorimin e rrjetit të shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e nivelit të cilësisë së furnizimit me energji elektrike;*

3. Tarifat për lidhjet e reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. *Parimi kryesor për detyrimin për realizimin e lidhjes së re është: Ai person fizik apo juridik që kërkon ndryshime në rrjetin e shpërndarjes, do të mbulojë të gjitha shpenzimet që lidhen me ndryshimin e rrjetit të shpërndarjes për të realizuar lidhjen e re.”*

Në pikën 4.2 dhe 4.3 të Rregullores përcaktohen punimet/shërbimet që do të paguhen nga aplikanti, si dhe mënyra e pagesës, si më poshtë:

“Aplikanti do të paguajë kostot që lidhen me shërbimet që do të kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe që përfshihen në tarifë, si më poshtë:

- *Pranimi dhe procesimi i aplikimit;*
- *Planifikimi i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për të mundësuar lidhjen e objektit të ri (studimi i vizibilitetit);*
- *Përcaktimi i pikës së lidhjes në Sistemin e Shpërndarjes;*
- *Kontrollin dhe miratimin e projektimit të paraqitur nga aplikanti;*
- *Furnizimin dhe instalimin e pajisjeve të përfshira në lidhjen e re, e cila do të realizohet nga subjekti i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, kolaudimin e tyre si edhe testimin e të gjitha pajisjeve të përfshira në lidhjen e re;*
- *Mbikqyrja, monitorimi dhe kolaudimi i punimeve ndërtimore dhe instalimeve;*
- *Instalimi i aparateve matëse të energjisë elektrike*
- *50 ml kabëll (koaksial ose fuqie sipas rasteve) për instalimin e matësit në klientët e pajisur me matës energjie me boks individual etj.*
- *Lidhja me rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;*
- *Vulosjen e bokseve individuale, vulosjen e transformatorëve matës të rrymës dhe tensionit.*

2. *Punimet/ Shërbimet që do të kryhen dhe përballohen nga Aplikanti janë:*

- *Projektimi për realizimin e lidhjes së re;*
- *Kryerja e të gjithë punimeve me karakter ndërtimor dhe elektrik (kabina, kanalet e kablllove, pajisjet komutuese , pajisjet transformuese etj);*

- *Koston e pjesës së kabëllit më shumë se 50ml, vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të këtij kabëlli në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. (klientët e pajisur me matës energjie me boks individual);*
- *Hapja e kanaleve të kabllave për realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndares, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, muftë, etj.), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë edhe sistemet rrugore;*
- *Testimi i lidhjes së realizuar;*
- *Lejet e duhura për ciklin e punës.”*

4.3. Mënyra e pagesës

- a. Aplikanti duhet të kryejë një pagesë për tarifën e lidhjes së re, e cila mbulon shpenzimet e përcaktuara më sipër.*
- b. Aplikanti do të mbulojë vetë shpenzimet e të gjitha punimeve dhe pajisjeve shtesë që janë të nevojshme për të realizuar lidhjen e re.*
- c. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të zbatojë praktikën e pagesës së plotë në avancë për të gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.*
- d. Në fund të kryerjes së punimeve, në rast se OSSH do të jetë operatori i licencuar, i përzgjedhur nga Aplikanti, për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e asaj ekzistuese, ajo do të përgatisë një faturë të detajuar të kostove, sasive dhe çmimeve të punimeve dhe materialeve të përdorura faktikisht për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, tek e cila në asnjë rast çmimet e përdorura nuk mundet të jenë më të lartë se vlera në treg e të njëjtit mall në momentin e realizimit të punimeve të lidhjes. Në rast diferencash mes preventivit të punimeve dhe kostove reale, palët sipas rastit do të paguajnë diferencat ose rimbursojnë ato palës tjetër.*
- e. Tarifa e T3 për fuqinë e kërkuar e cila paguhet nga aplikanti, nuk mund të jetë më e lartë se 300% e të ardhurave për frymë. Mbulimi i pjesës tjetër të tarifës që kalon shumën e përcaktuar më sipër, do të jetë objekt i rregullimit nga ERE.*

Për sa më sipër, rezulton se aplikanti, i cili kërkon të lidhë një kontratë furnizimi me energji elektrike duhet të mbulojë një pjesë të mirë të shpenzimeve për të kryer një lidhje të re në banesën e tij. Përgjatë hetimit administrativ rezultoi se familjet rome dhe egjiptiane, të cilat aktualisht nuk kanë kontratë furnizimi me energji elektrike nuk mund të përballojnë kosto të tilla.

Komisioneri gjykon se pavarësisht se dy prej parimeve, ku mbështetet përcaktimi i tarifave për konsumatorët nga OSHEE sh.a. është parimi i mosdiskriminimit dhe tarifat për lidhjet e reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sërish duhet të gjejnë vend

ndërmarrja e masave pozitive për ato kategori individësh, që e kanë të pamundur përballimin e tyre dhe konsiderohen si kategori në nevojë.

Komisioneri mbështetet për analogji në Vendimin nr.18, datë 12.01.2018, e Këshillit të Ministrave “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”, ku parashikohet shprehimisht subvencionimi i tarifës së lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë. Në pikën 2, të këtij Vendimi janë cilësuar si kategori në nevojë:

- a) Familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar);
- b) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe që nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;
- c) Familjet që kanë në përbërje anëtarë që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar;
- d) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror ose që përfitojnë pension pleqërie fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.

Referuar pikave 3 dhe 4, të Vendimit të sipërcituar, kategoritë e mësipërme, të cilat nuk disponojnë një kontratë të lidhur me Ujësjellës-Kanalizime sh.a. dhe nuk janë të pajisur me matës uji në banesë, do t’i përfitojnë ato pa pagesë.

Në kushtet kur, ndër 30 familjet rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, të cilat nuk kanë lidhur kontratë me OSHEE sh.a. Fier, ka 2 familje që janë përfituese të ndihmës ekonomike³, si dhe mund të ketë familje që i përkasin kategorive të mësipërme⁴, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se do të ishte e nevojshme ndërmarrja e masave pozitive, në zbatim të nenit 11, të ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

³ Referuar informacionit të përcjellë nëpërmjet shkresës nr. nr. 6122/1, datë 28.06.2018, të Bashkisë Fier.

⁴ Në mungese të kopjeve të kartave të identitetit të kryefamiljarëve të familjeve ankuese rome dhe egjiptiane të fshatrave Drizë, Baltëz dhe Levan, të qytetit të Fierit, të cilat nuk u dërguan nga përfaqësuesi i tyre pranë Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Fier nuk mundi të kryejë verifikime për identifikimin e tyre.

E parë në një këndvështrim më të gjërë, Komisioneri vlerëson se ndërmarrja e masave të tilla pozitive, për subvencionimin e plotë ose të pjesshëm të lidhjes së kontratave të furnizimit me energji elektrike dhe matësve përkatës, për të gjitha familjet në Republikën e Shqipërisë, do të ishte qasja e duhur nga ana e OSHEE sh.a., për mbështetjen e shtresave dhe kategorive në nevojë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1⁵, të Ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se në kushtet, kur OSHEE sh.a. ka hartuar akte, zbatimin e të cilave është i barabartë dhe i detyrueshëm për të gjithë, 30 familjet romë dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit, të cilat nuk kanë lidhur kontratë me OSHEE sh.a. Fier, nuk i janë ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga kësaj shoqërie.

Por pavarësisht kësaj, Komisioneri rekomandon për OSHEE sh.a., ndërmarrjen e masave pozitive për kategoritë në nevojë, duke u ndjekur si shembull subvencionimi i tarifës së lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë.

II. Shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes ex-officio, shkaqet e dyshuara të diskriminimit, kanë qenë “raca” dhe “gjendja ekonomike”, e familjeve romë dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit.

“Raca” dhe “Gjendja Ekonomike” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në pikën 1, të nenit 7 të ligjit të sipërpërmendur parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët

⁵ Neni 7, pika 1, e ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në mungesë të një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të këtyre familjeve nga ana e OSHEE sh.a., Fier, nuk mund të ketë diskriminim për asnjë nga shkaqet e sipërpërmendura.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 11, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma c), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “racës” dhe “gjendjes ekonomike”, të familjeve rome dhe egjiptiane të fshatrave Levan, Drizë dhe Baltëz, të qytetit të Fierit nga ana e OSHEE sh.a., Fier.
2. Rekomandohet marrja e masave pozitive nga ana e OSHEE sh.a., për subvencionimin e plotë ose të pjesshëm të tarifës së lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të energjisë elektrike, për kategoritë në nevojë.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira dhe sherbime
Shkak - “raca” dhe “gjendja ekonomike”